

LegalNews

SPECIAL

August 2020
Gusht 2020



I. Ligji për Regjistrin e Pronarëve Përfitues

Në Fletoren Zyrtare nr. 149 datë 13 Gusht 2020 është publikuar Ligji nr. 112/2020 datë 29.7.2020 "Për regjistrin e pronarëve përfitues" (në vijim referuar si "**Ligji për RPP**").

Ligji për RPP krijon Regjistrin e Pronarëve Përfitues, si një bazë të dhënash elektronike shtetërore nën administrimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në të cilin regjistrohen të dhënat e pronarëve përfitues të subjekteve që kanë detyrimin e raportimit të tyre sipas kërkesave të përcaktuara në ligj.

Regjistri i Pronarëve Përfitues synohet të sigurojë transparencën në fushën e pronarëve përfitues dhe do të shërbejë si një arkiv elektronik zyrtar.

Ky ligj është hartuar në vijim të rekomandimeve të MONEYVAL¹, si dhe është pjesërisht i harmonizuar me Direktivën e katërt të BE kundër parandalimit të pastrimit të parave².

Ligji për RPP, ndër të tjera, përcakton përkufizimin e "pronarit përfitues", subjektet të cilat detyrohen të regjistrojnë të dhënat (subjektet raportuese), mënyra e krijimit, funksionimit dhe administrimit të regjistrit të pronarëve përfitues, procedura dhe mënyra e regjistrimit dhe mbajtjes të të dhënave të regjistruara, aksesin në të dhënat e regjistrit si dhe masat ndëshkuese në rast të mosrespektimit të rregullave mbi regjistrimet.

¹ Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit pranë Këshillit të Evropës;

² Direktiva e BE 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit i datës 20 Maj 2015 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.

I. Law on the Register of Beneficial Owners

With the Official Gazette no. 149 of August 13, 2020 was published the Law no. 112/2020 dated 29.07.2020 "On the register of beneficial owners" (hereinafter referred as "**Law on RBO**").

The Law on RBO establishes the Register of Beneficial Owners, as an electronic state database near the National Business Center (NBC), which will contain information regarding the ultimate beneficial owners of the entities obliged to report pursuant to the legal requirements.

The Register of Beneficial Owners aims to ensure transparency on the beneficial owners and serve as an official electronic archive.

This law has been enacted pursuant to the recommendation of MONEYVAL¹ and is partially approximated with the 4th EU AML Directive².

The Law on RBO, among other, provides for the definition of "beneficial owners", the entities that are obliged to disclose data and information (the reporting entities), the manner of creation, functioning and administration of the register, the procedure and manner of registration and retention of data, the access on the information of the register and also the penalties for non-compliance with the obligations.

¹ Committee of Experts on the Evaluation of Anti-Money Laundering Measures and the Financing of Terrorism near the Council of Europe.

² Directive (EU) 2015/849 of the European Parliament and of the Council of 20 May 2015 on the prevention of the use of the financial system for the purposes of money laundering or terrorist financing.

- **Subjektet raportuese**

Subjektet të cilat detyrohen sipas Ligjit për RPP që të regjistrojnë pronarët përfitues në këtë regjistër janë personat juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë:

- Shoqëritë tregtare, degët/zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja, shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, si dhe çdo subjekt tjetër juridik, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKB-së;
- Organizatat fitimprurëse (si fondacionet, shoqatat, qendrat, degët e OJF të huaja);
- Personat juridikë dhe ndërmarrjet, aksionarët e të cilëve, përveç institucioneve qendrore dhe/ose vendore të Republikës së Shqipërisë, janë edhe individë/persona juridikë të tjerë shqiptarë dhe/ose të huaj;

- **Përkufizimi i pronarit përfitues**

Ligji për RPP përkufizon pronarin përfitues si, individin i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit subjektin dhe/ose individin në emër të të cilit po kryhet një transaksion. Ky përkufizim përfshin të paktën:

- Individin i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë të drejtpërdrejtë ose tërthortë të 25% (*njëzet e pesë për qind*) të aksioneve/të drejtave të votimit/pjesëmarrjes në kapital, ose përmes kontrollit nëpërmjet mjeteve të tjera, ose që përfiton nga transaksionet e kryera nga personi juridik në emër të tij;

- **Reporting Entities**

The entities, that are obliged by this law to register the beneficial owners with the register, are the legal entities registered in the Republic of Albania, as below:

- Commercial companies, branches/representative office of foreign companies, saving and credit companies and unions, mutual collaboration entities, cooperative entities, and any other legal entity that is obliged to register near NBC;
- Non for profit organizations (such as foundations, associations, centers, branches of foreign non for profit organizations);
- Legal entities and companies, which shareholders include, in addition to central and/or local institutions of the Republic of Albania other Albanian or foreign natural/legal entities.

- **Definition of beneficial owner**

The Law on RBO defines the beneficial owner as, the individual who ultimately owns or controls the legal entity and/or the individual on whose behalf a transaction is being conducted. This definition includes at least:

- The individual who ultimately owns or controls a legal entity, through direct or indirect ownership of 25% (*twenty five percent*) of the shares or voting rights or ownership interest in that entity, or through control via other means, or that benefits from the transaction performed by the legal entity on its account;

- Themeluesin ose përfaqësuesin ligjor ose individin që ushtron kontrollin e fundit efektiv në administrimin dhe kontrollin e organizatave jofitimprurëse;

- Në rastet e trusteve ose marrëveshjeve të tjera ligjore, krijuesi i trust-it, kujdestari/i mirëbesuari, mbrojtësi nëse ka, dhe përfituesit ose kur personat që përfitojnë nga marrëveshja ligjore ose entiteti ende nuk janë përcaktuar, klasa e personave për interesin kryesor të të cilëve operon ose është krijuar marrëveshja ligjore ose entiteti; çdo individ tjetër që ushtron kontrollin e fundit mbi trustin me anë të pronësisë drejtpërdrejtë ose tërthortë ose me mjete të tjera.

- The founder or the legal representative or the individual who exerts the ultimate effective control on the administration and supervision of the non for profit organizations;

- In the case of trusts and other legal agreements, the settlor, the trustee, the protector if any, the beneficiary or where the individuals benefiting from a legal arrangement or entity have yet to be determined, the class of persons in whose main interest operates the legal arrangement or entity; any other individual exercising ultimate control over the trust by means of direct or indirect ownership or by other means.

● **Të dhënat që regjistrohen për pronarët përfitues**

Subjektet raportuese duhet të regjistrojnë në lidhje me pronarët përfitues të dhënat e mëposhtme:

- Të dhëna në lidhje me identifikimin si emri, mbiemri, datëlindja, numri i identifikimit personal/pasaporta, adresa e rezidencës së përhershme;

- Të dhëna në lidhje me pronësinë si data e përcaktimit të individit si pronar përfitues, lloji (direkte apo indirekte) dhe përqindja e pronësisë.

● **The information to be registered with regard to beneficial owners**

The reporting entities must provide the following information with regard to the beneficial owners:

- Information regarding identification as name, surname, date of birth, personal identification/passport number, address of the permanent residence;

- Information regarding the ownership including the date of the determination of the individual as beneficial owner, the nature (direct or indirect) and extent of ownership.

- **Detyrimi për mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave**

Subjektet raportuese kanë detyrimin sipas Ligjit për RPP që të ruajnë dhe të mbajnë të dhëna dhe dokumente shoqëruese të duhura, të sakta e të përditësuara, në bazë të të cilave përcaktohen pronarët përfitues të subjektit dhe lloji i kontrollit të pronarëve përfitues.

Një tjetër risi e rëndësishme e sjellë nga Ligji për RPP është se autoriteti shtetëror inspektuese/verifikuese në fushën tatimore (organet tatimore), do të kryejnë në kuadër të kontrollit, verifikimit e respektimit të këtij detyrimi si dhe të saktësisë dhe përputhshmërisë të të dhënave të raportuara në regjistër.

- **Aksesi në regjistër**

Të dhënat e mëposhtme të regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues do të jenë publike dhe lirisht të aksesueshme:

- Emri dhe mbiemri i pronarit përfitues;
- Shtetësia;
- Viti dhe muaji i lindjes;
- Data e përcaktimit të individit si pronar përfitues;
- Lloji dhe përqindja e pronësisë.

Të dhënat e tjera të pronarëve përfitues mund të aksesohen nga personat e autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues si dhe nga autoritetet shtetërore në funksion të detyrave të tyre ligjore.

Gjithashtu, subjektet e detyruara sipas ligjit për parandalimin e pastrimit të parave apo dhe çdo person tjetër mund të marrin informacion për të dhënat që nuk janë të aksesueshme, në vijim të një kërkesë ku provojnë interesin e tyre të ligjshëm.

- **The obligation to maintain data and documents**

Pursuant to the Law on RBO, the reporting entities have the obligation to maintain adequate, accurate and up-to-date data and documents, which attest the beneficial owners and the nature of their ownership.

Another important novelty brought by the Law on RBO is that the tax authorities will perform the verification of the compliance of the entities of the above obligation as well as of the accuracy and conformity of the records with the information provided to the register, during the course of the usual tax audits.

- **The access to the register**

The following data registered in the Register of Beneficial Owners will be public and accessible unrestrictedly:

- Name and surname of the beneficial owner;
- Nationality;
- Month and year of birth;
- The date that the individual was determined as beneficial owner;
- Nature and extent of ownership.

The other data of the beneficial owners will be accessible to the authorized persons of the reporting entities and the state authorities during the performance of their functions.

Moreover, the entities of the law on anti-money laundering and any other member of the public may access the data for the restricted data pursuant to a request that shows their legal interest in having such information.

- **Mënyra e regjistrimit**

Regjistrimi i të dhënave të pronarit përfitues në regjistër bëhet nga personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, nëpërmjet sportelit elektronik.

QKB njofton vendimet dhe regjistrimet e saj nëpërmjet publikimit në regjistër.

Rregulla të mëtejshme në lidhje me këtë pikë priten të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

- **Kundërvajtjet dhe sanksionet**

Ligji për RPP përcakton këto sanksione për mosrespektimin dhe shkeljen e detyrimeve ligjore në lidhje me regjistrimin e pronarëve përfitues:

- Mospërbushja e detyrimit të subjekteve raportuese ekzistuese për regjistrimin e të dhënave dënohet me gjobë në vlerën 250.000 (*dyqind e pesëdhjetë mijë*) lekë;

- Mosregjistrimi fillestar i të dhënave të subjekteve të themeluara pas krijimit të regjistrit dënohet me gjobë në vlerën 500.000 (*pesëqind mijë*) lekë;

- Mosregjistrimi i ndryshimeve të të dhënave dënohet me gjobë në vlerë 250.000 (*dyqind e pesëdhjetë mijë*) lekë.

Këto sanksione vendosen nga titullari i QKB-së ndaj subjektit raportues dhe përfaqësuesit ligjor të subjektit raportues.

- **The procedure of registration**

The registration of data regarding the beneficial owners with the register will be performed electronically by the person authorized to represent the reporting entities.

The NBC will notify the registrations and its decisions via the publication on the register.

Detailed rules in relation to this point will be enacted by decision of Council of Ministers.

- **Violations and penalties**

Failure to comply with the legal obligations set out on the Law on RBO regarding the registration of the beneficial owners may lead to the imposition of the following sanctions:

- Noncompliance with the obligation of the existing reporting entities for the registration of the beneficial owners is punished with a fine in the amount of 250.000 (*two hundred fifty thousand*) ALL;

- Noncompliance with the obligation of the reporting entities founded after the creation of the register is punished with a fine in the amount of 500.000 (*five hundred thousand*) ALL;

- Failure to register changes of the registered information is punished with a fine in the amount of 250.000 (*two hundred fifty thousand*) ALL.

The penalties are imposed by the head of NBC to both the reporting entity and the legal representative of such entity.

Ndërsa, mospërbushja e detyrimit ligjor për mbajtjen e të dhënave dhe dokumentacionit të pronarit përfitues dënohet me gjobë në shumën 50.000 (*pesëdhjetë mijë*) lekë. Në këtë rast sanksioni vendoset nga organet tatimore në kuadër të kontrolleve të kryera.

- **Afatet kohore**

Ligji për RPP ka hyrë në fuqi 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Subjektet raportuese ekzistuese duhet që jo më vonë se 31.12.2020, të identifikojnë pronarët përfitues dhe të krijojnë e të mbajnë dokumentet përkatëse për pronarët përfitues.

Regjistri i Pronarëve Përfitues do të krijohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit jo më vonë se data 31.01.2021.

Subjektet raportuese ekzistuese duhet të regjistrojnë të dhënat e kërkuara për pronarët përfitues jo më vonë se 60 (*gjashtëdhjetë*) ditë kalendarike nga krijimi i regjistrit.

Këshilli i Ministrave pritet të miratojë rregulla më të detajuara në zbatim të Ligjit për RPP jo më vonë se 3 (*tre*) muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Meanwhile, the failure to comply with the legal obligation to maintain information and documents regarding the beneficial owners is punished with a fine in the amount of 50.000 (*fifty thousand*) ALL. In such case the sanction is imposed by the tax authorities in the course of their usual tax audits.

- **Time limits**

The Law on RBO entered into force 15 (*fifteen*) days after the publication with the Official Gazette

The reporting entities must identify their beneficial owners and collect the relevant documentation, not later than 31.12.2020.

The Register on Beneficial Owners will be established by the Ministry of Finance and Economy and the National Agency for Information Society, not later than the date of 31.01.2021.

The reporting entities, must proceed with the registration of the required data by law, within 60 (*sixty*) calendar days from the establishment of the Register on Beneficial Owners.

Pursuant to the Law on RBO, the Council of Ministers is expected to enact detailed rules for the implementation of the law within 3 (*three*) months of the entry in force of the law.

Si mund t'ju shërbejë Deloitte Legal?

Procesi i identifikimit të pronarit përfitues dhe përmbushja e detyrimeve ligjore të përcaktuara në Ligjin për RPP mund të jenë komplekse dhe sfiduese në varësi të strukturave të pronësisë së subjekteve.

Me zyrat e saj në qindra vende të botës duke pasur akses në një sërë juridiksionesh dhe me një ekspertizë të konsoliduar në këtë fushë, profesionistët e Deloitte Legal mund t'ju ndihmojnë në procesin e identifikimit të pronarit përfitues, krijimit të dokumenteve dhe të dhënave të kërkuara, regjistrimit si dhe përmbushjes së kërkesave ligjore, duke siguruar në të njëjtën kohë distancën dhe privatësinë e nevojshme në veprimtarinë e biznesit në vend.

How can Deloitte Legal help you?

The process of identifying the beneficial owners and fulfilling the legal obligations stipulated by the Law on RBO may be complex and challenging, depending on the ownership structure of the entities.

With its hundred offices around the world, having access in numerous jurisdictions and with a consolidated expertise and practice in such realm, Deloitte professionals may assist you towards the identification of the beneficial owners, collection of the required data and documents, registration and fulfillment of all stipulated legal obligations, while in the same assuring the necessary distance and privacy in the business operations in the country.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Sabina Lalaj

Local Legal Partner
Deloitte Legal sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mobile: + 355 68 37 33 130
E-mail: slalaj@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.